



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ Prot.

Himarë, më ____ / ____ / 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Shërbim printimi.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime printimi 79810000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 000 000 (dhjetëmilion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/b dhe nenin 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomikë dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar sa vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar...”.*

Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimimi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa*

konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e balanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si

dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është mbi kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin e nevojshëm teknik për realizimin e kontratës dhe të ketë të punësuar jo më pak se 4 (katër) punonjës.

Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për numrin mesatar të punonjësve dhe listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar përpara datës së hapjes së ofertave.

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht:

- 1 (një) specialist të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT;
- 2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit të ofruara në kuadër të kontratës;
- 1 (një) specialist të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit të ofruar.

Për specialistët e mësipërm duhet të paraqiten:

- Diploma ose dëshmi kualifikimi sipas profilit përkatës;
- Certifikatat përkatëse të kërkuara;
- Kontrata individuale e punës e vlefshme;
- Listëpagesa e muajit të fundit përpara datës së hapjes së ofertave, ku të figurojnë të regjistruar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të sipërpërmendur. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Objekti i prokurimit përfshin ofrimin e shërbimit të printimit, i cili nuk konsiston vetëm në vendosjen në dispozicion të pajisjeve të printimit, por edhe në instalimin, konfigurimin, monitorimin, mirëmbajtjen, riparimin e tyre, si dhe administrimin e platformës së menaxhimit të printimit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor vlerëson të

nevojshme që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet minimale njerëzore dhe teknike për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

Kërkesa për të patur jo më pak se 4 (katër) punonjës është vendosur duke marrë në konsideratë nevojën për mbulimin e funksioneve kryesore të kontratës, konkretisht:

- a) menaxhimin dhe koordinimin e shërbimit;
- b) mirëmbajtjen dhe asistencën teknike të pajisjeve të printimit;
- c) instalimin dhe konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit;
- d) garantimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar ITIL ose ekuivalent është vendosur për shkak se shërbimi përfshin elementë të menaxhimit të shërbimeve IT dhe mbështetjes teknike të përdoruesve. Certifikimi ITIL përfaqëson një standard ndërkombëtar të njohur për menaxhimin e shërbimeve IT dhe garanton njohuritë e nevojshme për organizimin, monitorimin dhe ofrimin e shërbimit sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Pranimi i certifikimeve ekuivalente siguron respektimin e parimit të mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë.

Kërkesa për 2 (dy) specialistë teknikë të certifikuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të printimit është vendosur për të garantuar ndërhyrjen e menjëhershme në rast defektesh, mirëmbajtjen periodike dhe funksionimin e pandërprerë të pajisjeve që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës. Duke qenë se shërbimi është i vazhdueshëm dhe lidhet drejtpërdrejt me veprimtarinë e autoritetit kontraktor, disponimi i dy specialistëve teknikë minimizon rrezikun e ndërprerjes së shërbimit dhe siguron mbulimin teknik në çdo kohë.

Kërkesa për 1 (një) specialist të certifikuar për instalimin dhe konfigurimin e platformës së menaxhimit të printimit është e nevojshme për të garantuar instalimin korrekt, parametrizimin, administrimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të printimit, i cili përbën një komponent thelbësor të shërbimit të kërkuar. Ky specialist siguron që platforma të integrohet me infrastrukturën ekzistuese të autoritetit kontraktor dhe të funksionojë sipas kërkesave teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e diplomave, certifikatave profesionale, kontratave individuale të punës dhe listëpagesave ka si qëllim verifikimin e ekzistencës reale të personelit të deklaruar dhe të kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të vlefshme ISO 9001:2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente, e lëshuar nga një organ certifikues i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga një organizëm akreditues i njohur ndërkombëtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Objekti i certifikimit duhet të jetë i lidhur me objektin e prokurimit ose me veprimtarinë e operatorit ekonomik që mundëson realizimin e kontratës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nganjë organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen

kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Objekti i kësaj procedure prokurimi lidhet me ofrimin e shërbimeve të printimit, të cilat kërkojnë organizim të mirë të proceseve të punës, kontroll të vazhdueshëm të cilësisë, menaxhim efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe respektim të afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor gjykon të nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë një sistem të certifikuar të menaxhimit të cilësisë.

Standardi ISO 9001:2015 është standard ndërkombëtar i njohur për sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe garanton që operatori ekonomik disponon procedura të dokumentuara për planifikimin, organizimin, kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës. Zbatimi i këtij standardi ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit të ofruar, në minimizimin e gabimeve gjatë procesit të printimit, në respektimin e specifikimeve teknike dhe në përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 9001:2015 ose ekuivalente është vendosur për të siguruar që operatori ekonomik disponon kapacitetet organizative dhe procedurat e nevojshme për realizimin e kontratës sipas standardeve të njohura të cilësisë. Pranimi i certifikatave ekuivalente garanton respektimin e parimeve të konkurrencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Kërkesa që certifikata të jetë e lëshuar nga një organ certifikues i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga një organizëm akreditues i njohur ndërkombëtarisht është vendosur për të garantuar vlefshmërinë, besueshmërinë dhe njohjen ligjore të certifikimit të paraqitur.

Gjithashtu, përcaktimi që objekti i certifikimit duhet të jetë i lidhur me objektin e prokurimit ose me veprimtarinë e operatorit ekonomik që mundëson realizimin e kontratës synon të sigurojë që certifikimi i paraqitur të jetë relevant dhe të mbulojë aktivitetet konkrete që lidhen me ofrimin e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë, broshura teknike, fletë teknike ose dokumentacion tjetër teknik të prodhuesit për pajisjet, materialet dhe produktet që do të përdoren për realizimin e shërbimit të printimit. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë përputhshmërinë e informacionit të paraqitur me kërkesat teknike të procedurës.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 41 pika 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Duke qenë se cilësia e shërbimit të printimit ndikohet drejtpërdrejt nga karakteristikat teknike të pajisjeve të printimit, materialeve harxhuese, platformave të menaxhimit të printimit dhe produkteve të tjera që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës, autoriteti kontraktor e konsideron të nevojshme disponimin e dokumentacionit teknik përkatës për të mundësuar vlerësimin objektiv të ofertave.

Paraqitja e katalogëve, broshurave teknike, fletëve teknike ose dokumentacionit të prodhuesit i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë parametrat teknikë, funksionalitetet, performancën, përputhshmërinë me kërkesat minimale teknike, si dhe karakteristikat e produkteve dhe pajisjeve të propozuara nga operatorët ekonomikë. Në mungesë të këtij dokumentacioni, autoriteti kontraktor nuk do të kishte mundësi të vlerësonte në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar nëse zgjidhja e ofruar përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit teknik nuk kufizon konkurrencën, pasi nuk përcakton marka, prodhues apo origjinë të caktuar, por synon vetëm verifikimin e karakteristikave teknike të pajisjeve dhe materialeve që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës. Operatorët ekonomikë kanë mundësinë të paraqesin çdo dokument teknik të lëshuar nga prodhuesi, për sa kohë ky dokument përmban informacion të mjaftueshëm për të provuar përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara.

E drejta e autoritetit kontraktor për të verifikuar përputhshmërinë e informacionit të paraqitur me kërkesat teknike të procedurës është vendosur me qëllim garantimin e saktësisë së të dhënave të deklaruara dhe mbrojtjen e interesit publik, duke siguruar që kontrata të realizohet me pajisje, materiale dhe produkte që plotësojnë standartet dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, të cilat garantojnë cilësinë, funksionalitetin, performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të kërkuar, duke i vlerësuar shërbimet dhe pajisjet si të pranueshme për realizimin e funksioneve administrative të autoritetit kontraktor, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Hartimi i specifikimeve teknike është realizuar mbi bazën e nevojave konkrete funksionale dhe operative të Bashkisë Himarë dhe institucioneve të saj në varësi, me qëllim garantimin e një sistemi printimi, fotokopjimi dhe skanimit të standardizuar, të qëndrueshëm, efikas dhe të pandërprerë gjatë gjithë periudhës kontraktuale prej 36 muajsh.

Përcaktimi i sasive të pritshme të printimit dhe fotokopjimit është bërë duke analizuar nevojat aktuale dhe projeksionet e ngarkesës administrative të institucionit për një periudhë afatmesme trevjeçare. Volumi i lartë i printimeve bardhë e zi dhe me ngjyra në formatet A4 dhe A3 lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin administrativ të përditshëm të Bashkisë Himarë, njësive administrative dhe strukturave të varësisë, të cilat realizojnë përpunim të vazhdueshëm të dokumentacionit zyrtar, materialeve administrative, dokumenteve financiare, formularëve, planeve, materialeve grafike, dokumenteve të urbanistikës, hartave, shkresave zyrtare dhe dokumentacionit tjetër teknik dhe institucional.

Në këtë kuadër, kërkesa për disponimin e një numri të caktuar pajisjesh multifunksionale A3 dhe A4, bardhë e zi dhe me ngjyra, është përcaktuar në funksion të garantimit të kapacitetit të nevojshëm operacional për të përballuar volumin e parashikuar të punës në të gjitha institucionet përfituese. Numri i pajisjeve është përcaktuar mbi bazën e shpërndarjes gjeografike të institucioneve, numrit të përdoruesve, intensitetit të përdorimit dhe nevojës për vazhdimësi të shërbimit pa ndërprerje. Kjo kërkesë synon të shmangë mbingarkesën e pajisjeve, vonesat në përpunimin e dokumentacionit dhe ndërprerjet e aktivitetit administrativ.

Përcaktimi i teknologjisë lazer si standard minimal teknik lidhet me faktin se kjo teknologji ofron performancë më të lartë, jetëgjatësi më të madhe të pajisjeve, cilësi më të qëndrueshme printimi dhe kosto më të ulët për faqe të printuar, krahasuar me teknologjitë alternative. Pajisjet lazer janë më të përshtatshme për ambiente institucionale me volum intensiv pune, pasi garantojnë shpejtësi më të lartë përpunimi, rezistencë më të madhe ndaj përdorimit të vazhdueshëm dhe stabilitet operacional në rrjetet me shumë përdorues.

Kërkesa për shpejtësi minimale printimi prej 30 faqesh në minutë është përcaktuar për të garantuar përpunim efikas të dokumentacionit administrativ dhe shmangien e vonesave gjatë proceseve të punës, veçanërisht në periudhat me ngarkesë të lartë dokumentacioni. Në të njëjtën kohë, rezolucioni minimal 600 x 600 dpi është kërkuar për të siguruar cilësi të pranueshme printimi dhe lexueshmëri të qartë të dokumenteve zyrtare, materialeve grafike dhe dokumentacionit teknik.

Kapacitetet minimale të sirtarëve të letrës dhe kapaciteti në dalje janë përcaktuar për të reduktuar ndërhyrjet manuale gjatë procesit të printimit dhe për të garantuar vazhdimësi në përdorimin e pajisjeve gjatë flukseve intensive të punës. Pajisjet me kapacitet më të lartë magazinimi të letrës reduktojnë kohën e ndërprerjeve për mbushje dhe rrisin efikasitetin operacional të administratës.

Kërkesa për memorje RAM mbi 1 GB është e domosdoshme për të garantuar përpunimin korrekt dhe të shpejtë të dokumenteve me përmbajtje komplekse, dokumenteve grafike, skanimeve dhe

printimeve në rrjet me shumë përdorues aktivë njëkohësisht. Kjo ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin dhe performancën e pajisjeve gjatë përdorimit intensiv institucional.

Mbështetja e formateve të ndryshme të letrës nga A6 deri në A3 është kërkuar për të garantuar fleksibilitet operacional dhe për të përmbushur nevojat e ndryshme administrative dhe teknike të institucionit. Format i A3 është i nevojshëm për printimin e planeve, tabelave, grafikëve, hartave dhe materialeve të tjera teknike ose prezantuese, ndërsa formati A4 mbulon pjesën më të madhe të dokumentacionit administrativ standard.

Funksionalitetet e skanimit në rrjet, përfshirë “Scan to e-mail”, “Scan to folder” dhe “Scan to FTP”, janë kërkuar në funksion të dixhitalizimit të proceseve administrative dhe menaxhimit elektronik të dokumenteve.

Këto funksionalitete mundësojnë qarkullim më të shpejtë të informacionit, ruajtje elektronike të dokumentacionit dhe integrim me sistemet e administrimit digjital të institucionit, duke reduktuar përdorimin fizik të dokumenteve dhe duke rritur efikasitetin administrativ.

Kërkesa për printim në të dyja anët (duplex) është vendosur me qëllim reduktimin e konsumit të letrës, uljen e kostove operative dhe promovimin e praktikave administrative me ndikim më të ulët mjedisor. Ky funksionalitet kontribuon gjithashtu në optimizimin e arkivimit dhe menaxhimit fizik të dokumenteve.

Lidhjet Ethernet dhe USB janë kërkuar për të garantuar integrim fleksibël të pajisjeve në infrastrukturën ekzistuese të rrjetit institucional dhe për të mundësuar përdorim të centralizuar nga shumë përdorues njëkohësisht. Lidhja në rrjet është një element thelbësor për funksionimin e sistemit të menaxhuar të printimit dhe administrimit e kontrolluar të përdoruesve.

Kërkesa për pajisje me ngjyra është e lidhur me nevojat institucionale për përgatitjen e materialeve zyrtare, dokumenteve prezantuese, grafikëve, hartave, materialeve informative dhe dokumentacionit që kërkon identifikim vizual dhe paraqitje me cilësi të lartë. Pajisjet me ngjyra janë të domosdoshme për një administratë moderne që realizon komunikim institucional dhe dokumentacion teknik të avancuar.

Përcaktimi i softuerit për menaxhimin e centralizuar të pajisjeve të printimit është bërë për të garantuar kontroll, monitorim dhe administrim eficient të të gjithë sistemit të printimit në institucion. Ky sistem lejon monitorimin në kohë reale të statusit të pajisjeve, evidentimin e problematikave teknike, kontrollin e konsumit të tonerëve dhe materialeve konsumuese, menaxhimin e përdoruesve dhe aksesit në pajisje, si dhe krijimin e raporteve të detajuara mbi volumet e printimit sipas përdoruesve dhe departamenteve. Kjo mundëson rritjen e transparencës administrative, kontrollin e kostove dhe optimizimin e përdorimit të burimeve.

Kërkesa për dërgimin automatik të njoftimeve me email në rast problemesh teknike ose niveleve të ulëta të tonerëve është përcaktuar për të garantuar reagim të shpejtë teknik dhe vazhdimësi të shërbimit pa ndërprerje. Gjithashtu, raportimet mujore mbi volumet e printimeve janë të nevojshme për kontroll administrativ, analizë të konsumit dhe menaxhim financiar të kostove të shërbimit.

Përfshirja në kontratë e të gjitha materialeve konsumuese, tonerëve, pjesëve të këmbimit dhe mirëmbajtjes teknike është kërkuar për të garantuar funksionim të pandërprerë të sistemit gjatë gjithë periudhës kontraktuale dhe për të shmangur kostot shtesë apo vonesat që mund të cenojnë aktivitetin normal të administratës. Kjo qasje siguron përgjegjësi të plotë të operatorit ekonomik për performancën e pajisjeve dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

Shtrirja e shërbimit në Bashkinë Himarë, Njësinë Administrative Lukovë dhe Njësinë Administrative Horë – Vranisht është përcaktuar për të garantuar standard të njëjtë shërbimi dhe akses të barabartë në të gjitha strukturat administrative të autoritetit kontraktor. Instalimi, konfigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në secilën njësi administrative janë të domosdoshme për të siguruar funksionim të koordinuar të sistemit, shpërndarje efikase të kapaciteteve dhe mbështetje teknike të vazhdueshme në çdo vendndodhje ku ofrohet shërbimi.

NJËSIA E PROKURIMIT